



PROGRAMI I PUNËS

për periudhën 2022-2024

PËRGATITUR NGA

ERMIR ROGOVA

KANDIDAT PËR REKTOR

PRISHTINË, NËNTOR 2022

“Dhe drit’ e diturisë përpara do na shpjerë.”

Naim Frashëri

PËRMBAJTJA

I. MISIONI DHE VIZIONI.....	3
II. PARIMET THEMELORE.....	3
III. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME	4
OBJEKTIVI 1: Cilësia në mësimdhënie dhe freskimi i programeve në pajtim me tregun e punës ...	5
OBJEKTIVI 2: Buxheti, infrastruktura dhe personeli.....	7
OBJEKTIVI 3: Integriteti dhe çështjet etike në publikimet shkencore si dhe anëtarësimi në Committee on Publication Ethics (COPE).....	9
Anëtarësimi në Komisionin për Etikën e Publikimit (Committee on Publication Ethics – COPE)	9
Rreth COPE	10
OBJEKTIVI 4: Nxitja e hulumtimit shkencor dhe aktualizimi i instituteve	11
OBJEKTIVI 5: Ndërkombëtarizimi dhe rrjetëzimi i UP-së.....	12
OBJEKTIVI 6: Digjitalizimi i shërbimeve akademike dhe studentore	14
OBJEKTIVI 7: Qasja në internet dhe në databazat bibliografike (shkencore)	16
Rreth eduroam	17
OBJEKTIVI 8: Rishikimi dhe hartimi i akteve ligjore qeverisëse në nivel të UP-së	18
OBJEKTIVI 9: Studentët dhe aktivitetet në kampusin universitar.....	19
OBJEKTIVI 10: Zhvillimi i zgjedhjeve në nivel përfaqësimi	20
IV. PËRFUNDIM.....	21

I. MISIONI DHE VIZIONI

Profesionalizmi, transparenca, funksionimi si duhet i mekanizmit të llogaridhënies dhe shfrytëzimi efikas i burimeve, garanton arritjen e të gjitha objektivave reale që janë të nevojshme për zhvillimin dhe përparimin e secilit institucion.

Në këtë frymë, **mision** i rektorit është sigurimi i zhvillimit, përparimit dhe modernizimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” në të gjitha aspektet e ndërlidhura me funksionin e Universitetit, përkatësisht ato të arsimit akademik, kërkimeve shkencore, krijimtarisë artistike, këshillimeve profesionale dhe fushave të tjera të veprimtarive akademike, sipas praktikave dhe standardeve perëndimore.

Për të siguruar këtë, rektori do të ofrojë udhëheqje cilësore dhe të pa-anshme në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe gjithnjë sipas praktikave më të mira.

Përmes kësaj, pretendohet që të adresohen çështjet të cilat ndikojnë në besueshmërinë e këtij institucioni dhe të mbahen të informuar të gjitha palët me interes si dhe të gjithë qytetarët e Kosovës.

Vizion i rektorit është që gjatë këtij mandati, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” të fillojë ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të tij ekzistuese në mënyrë që të përmirësojë ndjeshëm pozitën në renditjen botërore të universiteteve dhe bëhet anëtar me të drejta të plota në të gjitha forumet dhe mekanizmat relevante ndërkombëtare dhe duke e renditur UP-në, fillimisht, në mesin e 1500 universiteteve më të mira në botë.

II. PARIMET THEMELORE

E gjithë puna dhe aktiviteti që do të ndërmerret nga ana e menaxhmentit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” do të jetë e ndërtuar mbi parimet themelore të:

- Pavarësisë;
- Integritetit;
- Profesionalizmit;
- Besueshmërisë;
- Gjithë-përfshirjes;
- Bashkëpunimit,
- Transparencës dhe llogaridhënies; dhe
- Barazisë gjinore.

III. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Programi i paraqitur këtu është përpiluar në atë mënyrë që, përpos zotimeve individuale poashtu të jetë në linjë të plotë me Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK) 2022-2026.

Çështjet që lidhen me tregun e punës, integritetin, qeverisjen dhe buxhetin, ndërkombëtarizimin, avancimin e shkencës, metodologjinë mësimore, digjitalizimin, jetën studentore, e të ngjashme, janë objektiva tona që në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhen edhe me objektivat e përgjithshme në PSAK.

Andaj, duke marrë për bazë misionin dhe vizionin, si dhe duke u mbështetur në parimet themelore të paraqitura në pikën II, në vazhdimësi gjatë mandatit, synohet përmbushja e dhjetë objektivave të cilat konsiderohen të jenë tejet të rëndësishme dhe janë si më poshtë:

1. Cilësia në mësimdhënie dhe freskimi i programeve në pajtim me tregun e punës;
2. Buxheti, infrastruktura dhe personeli;
3. Integriteti dhe çështjet etike në hulumtimet shkencore si dhe anëtarësimi në Committee on Publication Ethics (COPE);
4. Nxitja e hulumtimit shkencor dhe aktualizimi i instituteve;
5. Ndërkombëtarizimi dhe rrjetëzimi i UP-së;
6. Digjitalizimi i shërbimeve akademike dhe studentore;
7. Qasja në internet dhe në databazat bibliografike (shkencore);
8. Rishikimi dhe hartimi i akteve ligjore qeverisëse në nivel të UP-së;
9. Studentët dhe aktivitetet në kampusin universitar;
10. Zhvillimi i zgjedhjeve në nivel përfaqësimi.

OBJEKTIVI 1: Cilësia në mësimdhënie dhe freskimi i programeve në pajtim me tregun e punës

“Universiteti duhet të veprojë si qendër institucionale dhe udhëheqëse për avancimin e dijes, ideve kreative dhe shkencës në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës”, thuhet në statutin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Aftësitë e një ligjëruesi për të përdorur njohuritë e tij/saj për zhvillimin e përvojave pedagogjike kuptimplota për studentët është masa e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Këto aftësi duhet të zhvillohen sa më parë që të jetë e mundur përmes trajnimeve të detyrueshme të stafit të ri për metodologjitë e mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe përmes modernizimit të ambienteve mësimore me mjete konkretizuese moderne dhe aktualizimit të burimeve të informatave.

Cilësia në mësimdhënie fillon me profesorin në qendër, ku rishikimi i materialit dhe programeve studimore përshtatet dhe freskohet me të arriturat shoqërore në nivelin global. Bartja e dijes nga profesori tek studenti nuk bën të dallojë shumë nga ajo që zbatohet në mjediset studimore perëndimore, prandaj konsiderohet që pikënisje të jenë çështjet e lartcekura.

Pajtueshmëria e programeve studimore dhe syllabuseve të lëndëve me tregun e punës është një element tjetër kyç që përcakton përzgjedhjen e këtyre programeve nga studentët dhe suksesin e tyre pas përfundimit të studimeve, sidomos në kohën e sotme kur konkurrenca në treg është tejet e madhe.

Në anën tjetër, ofrimi i një ambienti modern, të pajisur me mjete konkretizimi, laboratorë dhe literaturë të kohës, ku profesori do të mund të zhvillojë aktivitetin mësimor dhe ku mund të zbatohet praktikisht dija e fituar nga studentët, po ashtu është prioritet imediat.

Zhvillimi i procedurave monitoruese me indikator matës, të cilat mundësojnë vlerësimin e performancës në të dy anët (profesor – student) është po ashtu njëri nga instrumentet që siguron cilësi në mësimdhënie dhe mësimnxënie, andaj kjo duhet të përmbushet brenda këtij mandati. Pos kësaj, forcimi i zyrave për monitorimin e cilësisë në secilën njësi akademike është pjesë e strategjisë për sigurimin e cilësisë duke respektuar plotësisht edhe kërkesat e Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

Freskimi sekuencial i programeve studimore, ndonëse merr kohë, duhet të reflektojë lidhshmërinë me tregun e punës. Nuk janë të rralla rastet kur programet nuk pasqyrojnë kërkesat e tregut, ndaj edhe joshja e studenteve për të vijuar studimet në UP domosdoshmërisht zbehet. Që ky synim të përmbushet, do të kërkohet që programet ekzistuese të freskohen dhe ri-akreditimi i tyre qysh në vitin e parë të jetë në linjë të plotë me atë që e kërkon tregu; jo vetëm në kontekstin kosovar por edhe në atë ndërkombëtar.

Në këtë drejtim, krijimi i kushteve dhe grupeve bërthamë që do të kujdesen për cilësinë dhe freskimin e programeve studimore do të përfshijë, por pa u kufizuar në, çështje të tilla si në vijim:

- Ofrimi i programeve zhvillimore për profesoratin;
- Rishikimi dhe freskimi i detyrueshëm i syllabuseve dhe literaturës;
- Vlerësimi dhe gjurmimi i vazhdueshëm i programeve;
- Përfshirja e industrisë dhe përfillja e kërkesave të tyre;
- Aplikimi i vlerësimit të performancës përmes indikatorëve matës;
- Procesi i ri-akreditimit të programeve ekzistuese apo të reja në koherencë me kërkesat e industrisë/tregut të punës;
- Forcimi i zyrave të cilësisë dhe karrierës brenda njësive akademike;
- Sinkronizimi i metodologjisë mësimore me praktikat më të mira perëndimore.

Për të përmbushur këtë objektiv, ndonëse mund të mos realizohet plotësisht brenda afatit dyvjeçar, plotësimi i UP-së me njësi të reja akademike mund të jetë njëra nga alternativat më të mira afatgjata, përmes të cilës universiteti mbetet aktual dhe konkurrent në rajon e më gjerë.

Epoka e digjitalizimit gjithnjë e më tepër po imponon fokusimin e vëmendjes në shkencën kompjuterike, teknologjitë e informacionit dhe aplikimin e këtyre në fushat tjera. Kësisoj, pasurimi i UP-së me njësi të reja akademike të cilat dallojnë nga ato ekzistuese, mbetet synim për t'u përmbushur.

Kjo paraqitet si rezultat i zhvillimit të hovshëm të teknologjisë dhe kërkesës enorme të tregut për kuadro me kualifikime në këto fusha. Kosova sot, eksportin më të madh të dijes dhe shërbimeve e bën pikërisht në këto lëmi.

Natyrisht që shqyrtimi i këtyre çështjeve do të bëhet në koordinim të plotë me profesoratin, njësitë akademike, përfaqësues të industrisë, partnerët lokal dhe ndërkombëtarë të UP-së dhe ata në nivel institucional në Republikën e Kosovës.

OBJEKTIVI 2: Buxheti, infrastruktura dhe personeli

Universiteti i Prishtinës ka një buxhet relativisht të madh në krahasim me organizatat e tjera buxhetore, gjë që imponon aplikimin e një disipline të lartë fiskale në secilën hallkë të menaxhimit, përkatësisht shpenzimin e tij (buxhetit).

Planifikimi i mirëfilltë është pikënisja, e cila nuk duhet bërë mbi bazën e një shablloni që nuk është freskuar deri më tani, por ku identifikimi i nevojave të njësive akademike do të bëhet me efikasitet të lartë dhe me theks të veçantë në avancimin e kushteve arsimore dhe burimeve njerëzore.

Ndërtimi i kapaciteteve dhe hapësirave mësimore në drejtim të modernizmit të infrastrukturës dhe objekteve brenda kampusit të UP-së janë prioritetet e vazhdueshme. Edhe pse koha mund të kufizojë veprimet që duhet të ndërmerren në kuadër të këtij mandati, qëllimi i vazhdueshëm është që t'ju ofrojmë njësive akademike mjete të avancuara konkretizimi si dhe lehtësira përcjellëse të cilat do të bëhen garantues të suksesit të tyre.

Duke marrë parasysh buxhetin që shpenzohet për paga dhe mëditje, si dhe duke marrë parasysh pjesën e ulët që i kushtohet komponentëve infrastrukturorë dhe shkencorë, është me rëndësi që ky proporcion të ndryshojë në të mirë të të bërit shkencë në UP. Në këtë drejtim, shpërndarja e fondeve do të fokusohet aty ku kthimi nga investimi është shumë më i lartë. Nga një institucion pasiv absorbues, do të tentohet transformimi në një institucion produktiv/vetë-krijues, në të cilin përveç granteve qeveritare, si burim i të ardhurave do të përdoren edhe fondet nga institucionet dhe programet e BE-së (p.sh. aplikimi me projekte i personelit të UP-së në programin Horizon Europe) ku mundësia e përfitimeve është e madhe dhe jashtëzakonisht e dobishme për afirmimin e UP-së në arenën ndërkombëtare.

Për më tepër, kalimi gradual në institucion krijues lidhet po ashtu me pritshmëritë për krijimin të ardhurave që realizohen përmes ofrimit të shërbimeve për palët nga laboratorët ekzistues apo të rinj, ofertave për trajnime dhe certifikime profesionale për tregun e punës, si dhe gjenerimi i të ardhurave përmes instituteve dhe punës kërkimore/shkencore.

Rritja e transparencës dhe llogaridhënies për shpenzimin e parasë publike është një sfidë që kërkon vazhdimisht monitorim nga afër. Kjo arrihet me forcimin e kontrollit të brendshëm dhe disiplinës fiskale dhe administrative, e cila ka kohë që i ka munguar UP-së. Transparenca përmes publikimit të shpenzimeve të parasë publike, rritja e kompetencës profesionale dhe sjellja me përgjegjshmëri e personelit japin siguri të arsyeshme mbi pritshmëritë e cekura.

Personeli është burimi më i rëndësishëm që ka UP-ja dhe edukimi apo trajnimi i tyre i vazhdueshëm ndihmon në freskimin e njohurive me arritjet që imponon mjedisi. Një rishikim i pozicioneve brenda administratës, duke përfshirë përshkrimet e vendeve të punës, linjat e raportimit, monitorimi dhe krijimi i një kontrolli të brendshëm efikas, në përgjithësi është shumë i rëndësishëm për të siguruar përmbushjen e qëllimeve të parashtruara. Prandaj,

angazhimi për të vendosur disiplinën e punës në një mjedis koheziv është gjithashtu parakusht që mund të arrihet përmes rishikimit dhe freskimit të mozaikut qeverisës si dhe vendosjes së sistemit të vlerësimit të performancës, i cili mungon në UP në nivel administrate dhe me gjerë.

Prandaj, brenda këtij mandati synohet të ndërmerren veprime konkrete që ndërlidhen me aktivitetet si vijon:

- Forcimi i kontrollit të brendshëm nëpërmjet rishikimit të proceseve, procedurave, teknologjisë dhe rritjes së kompetencës profesionale;
- Planifikimi buxhetor me një bazë të gjerë dhe me pjesëmarrje të palëve kryesore që kujdesen për cilësinë dhe komponentin shkencor brenda njësive akademike;
- Investimi në TI, resurse kompjuterike dhe aplikacione softuerike (p.sh., anti-plagjiatura, pakot ekonometrike/statistikore, matematikore, etj.);
- Orientimi i fondeve investuese në projekte kapitale që sigurojnë kthim nga investimi dhe ngrisin vlerësimin e UP-së në arenën ndërkombëtare (p.sh. qasja në databazat dhe platformat elektronike bibliografike, krijimi i një databaze profesionale bibliografike për UP-në siç është COBISS, etj.);
- Sigurimi i fondeve shtesë nga shitja e shërbimeve të UP-së dhe nëpërmjet aplikimit të stafit në programet e BE-së, veçanërisht në Horizon Europe;
- Rritja e transparencës dhe decentralizimi i disa çështjeve buxhetore në nivel të njësive akademike;
- Prioritizimi i investimeve kapitale në infrastrukturën e njësive akademike, modernizimi i laboratorëve dhe pajisjeve të konkretizimit;
- Ndarja e fondeve për studentët dhe avancimi i jetës studentore në kampus;
- Rishikimi dhe përditësimi i kualifikimeve dhe kompetencave profesionale, linjave të raportimit, përshkrimeve të punës dhe sigurimi i kryerjes së detyrave në kohë dhe në një mjedis të kontrolluar mirë;
- Rritja e mekanizmit të llogaridhënies dhe transparencës përmes raportimit të rregullt dhe publikimit të raporteve në ueb faqen e UP-së;

Çdo aktivitet që do të ndërmerret në UP do të jetë në përputhje me kornizën ligjore që rregullon çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike, prokurimin apo shpenzimin e parasë publike, si dhe rregulloret e tjera që rregullojnë fushëveprimin e aktiviteteve në UP, si ligji për arsimin e lartë, statuti dhe akte të tjera nënligjore.

OBJEKTIVI 3: Integriteti dhe çështjet etike në publikimet shkencore si dhe anëtarësimi në Committee on Publication Ethics (COPE)

Ballafaqimi me çështjet etike në jetën akademike nuk është i panjohur, por trajtimi në formën e parandalimit dhe adresimit të mëtejshëm të këtyre dukurive, që ulin integritetin akademik, janë parakushte për një mjedis të besueshëm në kampusin universitar të UP-së. Integriteti akademik rrit besimin e shoqërisë dhe përafron institucionin me vlerat e përbashkëta perëndimore.

Për të mundur këtë, nevojitet urgjentisht përgatitja e një baze të mirëfilltë ligjore, e cila deri më tani i ka munguar UP-së. Në këtë drejtim, trajtimi i çështjeve etike në funksion të rritjes së integritetit akademik do të përfshijë, por pa u kufizuar në:

- Plagjiaturën;
- Vetëplagjiaturën;
- Prerjen/rriska e sallamit (salami slicing);
- Kopjimin e paautorizuar;
- Riprodhimin e materialit shkencor;
- Autorësinë dhe radhitjen;
- Autorin kryesor;
- Autorin korrespondent;
- Grupin e autorëve;
- Konfliktin e interesit, etj.

Krijimi i bazës ligjore është parakusht për të vazhduar me trajtimin e çështjeve etike dhe ndër prioritetet e UP-së në këtë mandat. Përmes saj, UP-ja do të jetë institucioni i parë në Kosovë që do të nxjerrë bazën ligjore për Parimet e Etikës, Transparencës dhe Praktikave më të mira në publikimet shkencore. Natyrisht që hartimi i rregullores do të bëhet në koordinim të plotë me partnerët ndërkombëtarë të UP-së dhe ata në nivel institucional në Republikën e Kosovës.

Anëtarësimi në Komisionin për Etikën e Publikimit (Committee on Publication Ethics – COPE)

Për të arritur dhe siguruar përmbushjen e objektivit 3 në mënyrë më efektive, krahas bazës ligjore, për të siguruar paanshmëri në trajtimin e çështjeve etike, përkatësisht për të lehtësuar procesin dhe për të rritur transparencën kur flitet për mungesë etike rreth publikimit dhe angazhimit akademik, brenda një kohe të arsyeshme do të bëhen përpjekje dhe përgatitjet e nevojshme për të aplikuar dhe qenë anëtar i Komisionit për Etikën e Publikimit (Committee on Publication Ethics – COPE). Pjesëmarrja në këtë mekanizëm mundëson trajtimin e rasteve në mënyrë më të mirë të mundshme dhe ofron bazë për paanshmëri gjatë procesit të vlerësimit të integritetit akademik në UP.

Rreth COPE

COPE u krijua për të ofruar këshilla dhe udhëzime mbi praktikat më të mira për trajtimin e çështjeve etike në botimin e revistave. COPE është një organizatë e përkushtuar për të edukuar dhe mbështetur redaktorët, botuesit, universitetet, institutet kërkimore dhe të gjithë të përfshirët në etikën e publikimit. COPE synon të lëvizë kulturën e botimit drejt asaj ku praktikat etike bëhen pjesë e rregullt e vetë kulturës. Qasja e COPE është e vendosur në drejtim të ndikimit nëpërmjet edukimit, burimeve dhe mbështetjes së anëtarëve, krahas nxitjes së debatit profesional në komunitetin e gjerë. COPE mbështet anëtarë në mbarë botën nga të gjitha fushat akademike.

Përfitimet e anëtarësimit janë shumë herë më të mëdha se kostoja, ndaj do të punohet për të përmbushur këtë objektiv në kohë dhe në vitin e parë të mandatit.

OBJEKTIVI 4: Nxitja e hulumtimit shkencor dhe aktualizimi i instituteve

Universiteti i Prishtinës veprimtarinë e vet e zhvillon në dy komponentë; mësimdhënia dhe hulumtimi. Për dallim prej mësimdhënies, të bërit shkencë ka disa avantazhe kur flitet për krijimin e fondeve dhe inovacioneve. Që kjo të realizohet, shihet e nevojshme themelimi ose riaktivizimi i instituteve të cilat kyçen drejtpërdrejtë në nxjerrjen e rezultateve shkencore.

Duke marrë shembull nga praktikat ndërkombëtare, secili profesor i punësuar në UP do të jetë personel i institutit në secilën njësi akademike ku funksionon instituti. Secilit institut do t'i kërkohet, që gjatë një viti, të ketë një numër të caktuar të aplikimeve në programet ndërkombëtare, ku projekti kurorëzohet me publikimin e të paktën një punimi shkencor. Përpos kësaj, synohet krijimi i një buxheti të veçantë në bashkëpunim me MASHTI-n, përmes të cilit do të nxitej i gjithë personeli që të aplikojë me idetë dhe projektet e tyre në fushat e caktuara, të cilat projekte do t'i sillnin benefitet e nevojshme UP-së dhe shoqërisë së Kosovës. Kjo nënkupton nxjerrjen dhe publikimin e revistave shkencore si dhe prezantimin e rezultateve empirike në to. Synohet që revistat të marrin indeksime kredibile ndërkombëtare.

Duke u bazuar në këto premisa, shihet si lehtësisht e arritshme lartësimi i pozitës së UP-së në arenën ndërkombëtare duke e mundur pozicionimin brenda pak viteve në 1500 top universitetet botërore, nga pozita aktuale 3000+.

Në mënyrë që të përmbushet ky objektivi, parashihen aktivitetet si në vijim:

- Skanimi i gjendjes ekzistuese;
- Mbledhja dhe analizimi i të dhënave, përditësimi i ueb-faqes së UP-së;
- Hapja, përkatësisht ri-aktualizimi i instituteve brenda njësive akademike;
- Krijimi i bazës ligjore për punën e instituteve dhe personelit që punon në to, përfshirë personelin akademik;
- Organizimi i konferencave, simpoziumeve dhe tryezave të rrumbullakëta nga institutet;
- Krijimi i një fondi për shkencën në koordinim me MASHTI-n sa i përket financimit të revistave shkencore;
- Rritja e rezultateve shkencore përmes hulumtimeve kuantitative dhe kualitative.

OBJEKTIVI 5: Ndërkombëtarizimi dhe rrjetëzimi i UP-së

Ndërkombëtarizimi i UP-së është një komponentë e rëndësishme e cila e rritë mundësinë e njohjes së universitetit në arenën ndërkombëtare. Duke marrë për bazë dinamikën e trendëve globale në arsim dhe hulumtime shkencore, aplikimi në programet dhe projektet ndërkombëtare nuk mund të bëhet i vetëm. Gjithnjë e më tepër, bashkëpunimi në konzorciume duket të jetë imperativ i kohës.

Me këtë rast, Universiteti i Prishtinës do të përfitojë nga anëtarësimi i Kosovës në programin më të madh që ka pasur ndonjëherë BE-ja, atë të Horizon Europe. Mundësitë që ofron ky program janë të panumërta dhe përpos ndërkombëtarizimit do të mundësohet edhe bashkëpunimi dhe rrjetëzimi me institucionet e tjera homologe, gjithandej.

Përtej kontekstit evropian, është shumë me interes që të avancohet pozita e UP-së edhe përmes bashkëpunimit me SHBA-në nëpërmjet programeve të përbashkëta si dhe ofrimit të bursave që kanë në fokus avancimin e stafit dhe shkëmbimin e studenteve ndërmjet vendeve tona (Fullbright, Humphrey Fellowship Program, etj.).

Ndaj, përpjekjet do të fokusohen në inkurajimin dhe krijimin e mundësive që personeli të aplikojë për fondet e BE-së apo ato evropiane në cilindo program (Horizon Europe, Erasmus +, HERAS, ADA, etj.) apo ato të partnerëve amerikanë (përmes ambasadës së SHBA-së në Kosovë), përmes projekteve individuale apo në konzorcium me partnerët ndërkombëtarë. Kjo përpos që ndërkombëtarizon UP-në, mundëson po ashtu edhe gjenerimin e të ardhurave për universitetin dhe hap perspektivën e të bërit shkencë për personelin duke rritur edhe mundësinë e punësimit të hulumtuesve të rinj.

Përpos kësaj, synohet që UP-ja të hapet edhe më tutje dhe të ofrojë studime në të gjitha njësitë akademike në gjuhën angleze, në bashkëpunim me universitete të tjera të cilat mund të jenë partnerë eventualë në konzorcium.

Rrjetëzimi i UP-së krijon avantazhe të shumta nga të cilat mund të përfitojë stafi akademik dhe studentët. Kjo përpos që përfshin mobilitetet, mundëson edhe bartjen e përvojave dhe dijes nga universitetet më përparimtare në kontekstin tonë.

Ekziston përkushtimi që të krijohen sa më shumë kontakte me qëllim të lidhjes së marrëveshjeve me universitetet tjera të cilat kanë kaluar nëpër fazat e tranzicionit dhe nga të cilat UP-ja mund të përfitojë shumë.

Për t'u përmbushur objektivi 5, planifikohet si në vijim:

- Inkurajimi i personelit dhe rritja e aplikimeve individuale apo në konzorcium në sasi dhe cilësi në programet e BE-së, me theks të veçantë në programin Horizon Europe (HORIZON);

- Rritja e bashkëpunimit në projekte të përbashkëta në programet ndërkombëtare, ku UP-ja do të ketë rolin e udhëheqësit të konzorciumit;
- Rrjetëzimi i UP-së me institucionet tjera partnere me qëllim të bartjes së dijes dhe praktikave ndërkombëtare në UP;
- Ofrimi i programeve studimore në gjuhën angleze, në veçanti programet e nivelit master dhe doktoratë;
- Krijimi i kontakteve dhe zhvillimi i kurrikulave me bashkëpunim ndërkombëtar;
- Krijimi i një zyre të veçantë që merret ekskluzivisht me përgatitjen e personelit për aplikime në projekte ndërkombëtare.

OBJEKTIVI 6: Digjitalizimi i shërbimeve akademike dhe studentore

Ne jemi në epokën e transformimit digjital dhe nëse nuk e përqafojmë atë me siguri do të ngecim pas. Për universitetet, ky transformim apo avancim drejt një mjedisi më të përqendruar tek teknologjia, ku njohuritë dhe shërbimet mund të përcillen përmes klikimit të një butoni është hapi logjik i radhës.

Ueb faqja e një institucioni konsiderohet të jetë fytyra virtuale e tij. Ajo është pika e parë e kontaktit ndërmjet botës së jashtme dhe institucionit. Aktualisht, ueb faqja e universitetit është vështirë e navigueshme dhe në të jo lehtë gjendet informacioni i dëshiruar. Këtë mendim e kanë edhe ekspertët e akreditimit, të cilët ueb faqen e universitetit e identifikojnë si pikë të dobët në të cilën duhet të punohet, sidomos duke marrë parasysh që informacioni në gjuhën angleze është tepër i mangët.

Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS), që është në përdorim, është një mjet që ndihmon në menaxhimin e studentëve, mirëpo funksioni i tij nuk është i optimizuar. Stafi akademik aktualisht detyrohet që notat e studentëve pas vendosjes në SEMS t'i dorëzojë edhe fizikisht në zyrën për shërbimin e studentëve. Për më tepër, nuk ekziston një procedurë standarde për këtë. Nëse kemi një sistem të besueshëm digjital, atëherë kjo është plotësisht e panevojshme, shkakton humbje kohe dhe keqpërdorim enorm të letrës dhe ngjyrës.

Digjitalizimi ka për qëllim lehtësimin e punës së personelit dhe studentëve, prandaj në këtë aspekt SEMS-i duhet të ofrojë edhe shërbime të tjera. Këto shërbime duhet të përfshijnë edhe lëshimet e dokumenteve të ndryshme nga sistemi të cilat duhet të kenë nënshkrime digjitale dhe të jenë lehtësisht të verifikueshme nga kushdo përmes kodeve QR.

Digjitalizimi i shërbimeve nuk duhet të përfundojë te ueb faqja dhe SEMS-i. Ai duhet të ngërthejë në vetvete edhe një platformë të menaxhimit të mësimin në nivel të Universitetit, të ngjashëm me **blackboard**, **moodle** ose **drupal**, ku stafi akademik do të postojë materialet, kuizet, detyrat dhe të gjitha informatat e tjera lidhur me lëndët, kurse studentët mund t'ju qasen informatave, të deponojnë punimet dhe detyrat e tyre, të formojnë grupe diskutimi dhe të kontaktojnë profesorin apo asistentin e lëndës. Në këtë mënyrë mundësohet një nivel shumë më i lartë i interaksionit ndërmjet mësimit dhe studentit.

Në mënyrë që të përmbushet ky objektivi, parashihen aktivitetet si në vijim:

- Auditimi i ueb faqes së universitetit me qëllim të identifikimit të pikave të dobëta të navigimit;
- Ri-dizajnimi me qëllim të optimizimit SEO të ueb faqes;
- Ri-dizajnimi multilingual i ueb-faqes;
- Auditimi mbi besueshmërinë e SEMS-it;
- Ri-dizajnimi eventual i SEMS-it dhe lidhja e tij me platformën e menaxhimit të mësimin;

- Zgjerimi i SEMS-it me module të reja për lëshimin dhe verifikimin digjital të dokumentacionit;
- Rishikimi dhe unifikimi i procedurave që ndërlidhen me SEMS-in;
- Hulumtimi, përzgjedhja dhe instalimi i një platforme të menaxhimit të mësimin në nivel të universitetit.

Gjatë këtij mandati, planifikohet që të bëhet një përmirësim i dukshëm i shërbimeve digjitale ekzistuese. Kjo nënkupton edhe trajnime shtesë për anëtarët e stafit si dhe krijimin e rregullores për qasjen në sistemet digjitale në kuadër të kampusit të Universitetit të Prishtinës.

OBJEKTIVI 7: Qasje në internet dhe në databazat bibliografike (shkencore)

Përdorimi i internetit sot është i lidhur pandashëm me procesin mësimor dhe atë hulumtues. Pa qasje në internet nuk mund të imagjinohen aktivitetet hulumtuese por edhe ato mësimore dhe administrative. Aktualisht, në kampusin universitar, qasje në internet realizohet përmes lidhjeve fizike nëpër kabinate dhe zyra dhe përmes pikave të qasjes wi-fi të cilët janë të shpërndarë nëpër lokacione të ndryshme. Megjithatë, lidhjet në pikat e qasjes pa tela (access points) nuk janë aspak të standardizuara dhe fjalëkalimet ndahen ndërmjet studentëve. Kjo mënyrë e qasjes është tejte joefikase dhe e pasigurtë.

Ajo çka nevojitet është zhvillimi, instalimi dhe shpërndarja e një sistemi të integruar, ku secili student dhe anëtar i stafit do të mund të qasej automatikisht në cilëndo pikë qasjeje brenda kampusit duke përdorur kredencialet e tyre, pa marrë parasysh se në cilën pjesë të kampusit gjinden. Ky sistem, përveç që lehtëson qasjen në internet, në platformat mësimore dhe bibliotekat elektronike, do të rriste sigurinë e sistemit dhe do të lehtësonte menaxhimin e rrjetit brenda kampusit universitar.

Në këtë frymë, planifikohet anëtarësimi në platformën **eduroam**, që është një platformë ndërkombëtare me kosto modeste të implementimit e cila siguron qasje të ndërsjellë të studentëve dhe stafit akademik në kampuset e të gjitha universiteteve dhe instituteve hulumtuese që janë pjesë e kësaj platforme.

Poashtu planifikohet anëtarësimi në biblioteka të ndryshme digjitale, të cilat do t'i mundësojnë stafit akademik dhe studentëve qasje të shpejtë dhe të lehtë si në literaturën bashkëkohore ashtu dhe në punimet shkencore të publikuara në revistat ndërkombëtare, gjithmonë nën ombrellën e sigurisë që do të ofrojë rrjeti brenda kampusit.

Në mënyrë që të përmbushet ky objektivi, parashihen aktivitetet si në vijim:

- Skanimi i gjendjes ekzistuese;
- Mbledhja dhe analizimi i të dhënave për përcaktimin e pozitave adekuate për mbulim me wi-fi;
- Prokurimi dhe instalimi i pajisjeve nëpër pika e paracaktuara;
- Instalimi i sistemit të integruar të qasjes;
- Anëtarësimi në eduroam dhe konfigurimi i sistemit;
- Anëtarësimi në biblioteka të ndryshme digjitale ndërkombëtare;
- Krijimi i një databaze bibliografike në kuadër të universitetit, ngjashëm me COBISS.

Rreth eduroam

Eduroam (romingu arsimor) është një shërbim i sigurtë, ndërkombëtar, i qasjes në shërbime, i zhvilluar për komunitetin ndërkombëtar të hulumtimit dhe edukimit. Ai iu mundëson studentëve, hulumtuesëve dhe stafit nga institucionet pjesëmarrëse të kenë lidhje interneti në të gjithë kampusin e tyre, si dhe kur ata vizitojnë institucione të tjera pjesëmarrëse, përmes kredencialeve të tyre studentore apo të stafit.

Eduroam është i disponueshëm në mijëra lokacione në mbi 100 shtete në mbarë botën. Bazohet në standardet më të sigurta të kriptimit dhe autentifikimit që ekzistojnë sot. Siguria e tij tejkalon shumë nga pikat e qasjes të zakonshme.

OBJEKTIVI 8: Rishikimi dhe hartimi i akteve ligjore qeverisëse në nivel të UP-së

UP-ja qeveriset mbi bazën e një numri të madh të akteve ligjore të cilat janë hartuar përgjatë viteve, një numër i konsiderueshëm i të cilave mund të kërkohej të përditësohet me aktualitetin dhe rrethanat në të cilat funksionon UP-ja.

UP-ja ka një kod etik që mbulon (edhe pse jo mjaftueshëm) disa çështje rreth integritetit, i hartuar në vitin 2013, porse nuk ka asnjë akt ligjor që mbulon plotësisht çështjet etike në publikimet shkencore apo akademike. Qëllimi i rishikimit të kornizës ligjore ekzistuese, apo hartimi i akteve të reja ligjore ka një qëllim; të funksionalizojë punën e mirë në UP në të gjithë të ashtuquajturin mozaik qeverisës (administratë, financa, prokurim, çështje akademike, aspekte juridike, etj.). si dhe të forcojë integritetin akademik në masën që të rrisë besueshmërinë në mjedisin më të madh të arsimit të lartë në vend.

Përveç kësaj, egzistojnë një sërë rregulloresh të cilat nuk janë përditësuar për të pasqyruar rrethanat aktuale, apo gjejnë zbatim të kufizuar në UP (p.sh. Rregullore për mobilitetet akademik të studentëve, Rregullore e vlerësimit të cilësisë në UP). Prandaj, identifikimi i këtyre akteve dhe përditësimi në lidhje me atë që dikton mjedisi synohet të fillojë në këtë periudhë kohore e cila imponon nevojën e harmonizimit me aktet ligjore jashtë UP-së.

Është e qartë se kjo do të marrë kohë, por ajo që ka rëndësi parësore është rishikimi i kodit të etikës dhe nxjerrja e një akti ligjor që do të parandalonte ose do të përcaktonte konturat e një vlerësimi të duhur të çështjeve që lidhen me integritetin dhe etikën në publikim në përgjithësi, siç e kemi përmendur më lartë.

Pa u zgjeruar shumë, në një formë më të ngjeshur, por pa u kufizuar, objektivi i tetë zërthehet në këto synime programore:

- Rishikimi dhe përditësimi i kodit të etikës;
- Rritja e nivelit të integritetit në UP në çdo nivel të përfaqësimit, qoftë akademik apo jo akademik;
- Identifikimi i të gjitha akteve ligjore që nuk zbatohen në UP ose që janë të vjetruara dhe shfuqizimi i tyre;
- Në bashkëpunim me KD dhe MASHTI të fillohet përditësimi i Statutit të UP-së në mënyrë që qëllimet e paraqitura të kenë mbështetje statutare;
- Nxjerrja e një akti ligjor për harmonizimin me qëndrimet e AKA-së lidhur me çështjet etike në publikim, cilësinë në mësimdhënie dhe të ngjajshme;
- Mundësia e krijimit të bazës ligjore për decentralizimin e disa prej çështjeve që kanë të bëjnë me administrimin dhe financat në nivel të njësive akademike.

Pavarësisht këtyre synimeve, është e dëshirueshme dhe e pritshme që UP-ja, nga një institucion i tipit “**Land-grant university**”, të shndërrohet gradualisht në një institucion vet-krijues. Ky është synim afatgjatë, por lëvizjet e para do të behën në këtë mandat.

OBJEKTIVI 9: Studentët dhe aktivitetet në kampusin universitar

Studentët janë palë e rëndësishme e interesit në UP dhe gjithmonë në rolin parësor. Ofrimi i mësimdhënies cilësore është primar, por poashtu është edhe sigurimi i kushteve për zhvillimin e jetës studentore, sportit, kulturës, letërsisë, shkencës, etj. Studentët marrin bursa të rregullta vjetore, por planifikohet rritja e numrit të përfitueseve në koordinim me KD dhe kriteret që vendosen.

Poashtu, në koordinim me njësitë akademike do të mund të ofronim më shumë hapësira për lexim dhe aktivitete argëtuese, në mënyrë që mësimnxënia dhe aktiviteti studentor të jenë më tërheqëse për ta.

Studentët, që në fillim, do të ftohen të ofrojnë projektet e tyre për zhvillimin e jetës në kampus dhe të njëjtat projekte zhvillimore do të jenë pjesë e buxhetit të UP-së në mënyrë të specifikuar. Krahas investimeve në infrastrukturë, do të mbështetet pa asnjë hezitim edhe zhvillimi i qendrave për aktivitete që nxisin masën inovative dhe që i'u shërbejnë drejtpërdrejt përmirësimit të kushteve të studentëve. Me pak fjalë, në bashkëpunim me studentët, premtohet krijimi i një plani të detajuar për financimin e projekteve studentore, ku vet studentit të jetë në qendër të vendimmarrjes për të gjitha detyrat dhe aktivitetet që lidhen me atë; procesin arsimor, këndet e leximit, rekreacionin, pra zhvillimin e jetës studentore në përgjithësi.

Debatet letrare, shfaqjet teatrale, përfshirja në projekte shkencore, laboratorë dhe mundësia e financimit të gjithë kësaj veprimtarie studentore do të jenë të mundura në këtë mandat dhe për këtë egkziston përkushtimi për realizim në bashkëpunim me studentët, Këshillin Drejtues dhe palët e tjera me interes, qofshin institucionet vendase apo partnerët ndërkombëtarë.

Në këtë kontekst, për studentët do të zhvillohen synimet programore me sa vijon:

- Buxheti i ndarë për studentët si kategori specifike në kuadër të linjës së prorektorit për mësimdhënie;
- Ndarja e bursave dhe çmimeve të tjera nxitëse;
- Planifikimi i aktiviteteve investuese në koordinim me studentët (ku promovohet arti, muzika, sporti, shoqatat e studentëve-asociacionet e vogla, rekreacioni i studentëve, etj.);
- Krijimi i një mekanizmi monitorues të performancës sa i përket zbatimit të projekteve/aktiviteteve studentore, etj.

OBJEKTIVI 10: Zhvillimi i zgjedhjeve në nivel përfaqësimi

Zgjedhjet janë një proces formal i vendimmarrjes në grup, me anë të së cilit një pjesë/masë aktive institucionale zgjedh një ose disa individë për të mbajtur poste publike.

Do të jetë ndër objektivat e këtij menaxhmenti, që zhvillimi i zgjedhjeve të ardhshme të realizohet në mënyrë të sigurtë, sinqertë dhe pa mundësi manipulimi. Do të implementohen praktikat më të mira dhe më të sigurta të votimit dhe numërimit të votave dhe do të sigurohet që vullneti i studentëve dhe stafit për zgjedhjen e përfaqësueseve të tyre të realizohet në formë korrekte, të drejtë dhe pa ndërhyrje.

Ky objektivi do të kurorëzohet me realizimin e planit tonë programor për dy vitet e ardhshme dhe me zbatimin e tij do të arrihen rezultate konkrete të cilat do të shërbejnë si bazë e mirë për suksesin e UP-së në mandatin e ardhshëm.

IV. PËRFUNDIM

Zbatimi i programeve të punës është sfidues dhe praktika ka treguar se ato nuk janë zbatuar plotësisht nga institucionet përkatëse.

Programi që u lexua pasqyron në mënyrë reale gjendjen në UP si dhe resurset që janë në dispozicion, njerëzore dhe materiale, për të përmbushur objektivat e këtij plani të punës. Për më tepër, ai është ambicioz, por me një ekip të përgatitur dhe nën drejtimin tim, objektivat e vendosura do të përmbushen dhe mbase edhe do të tejkalohen. Është e rëndësishme të theksohet se çdo objektiv i këtij plani është në përputhje me objektivat strategjike të vendosura në PSAK 2022-2026 dhe çdo aktivitet i ndërmarrë do të përcjellë të njëjtë vijë.

Po ashtu, objektivat në këtë program janë të arkitekturës SMART (specific, measurable, achievable, realistic and timely), dhe për secilën është dhënë një përshkrim që ndërlidhet me veprime konkrete që synohen të zbatohen apo arrihen brenda mandatit.

Instalimi i mekanizmit të përgjegjshëm, llogaridhënës dhe transparent, në çdo nivel drejtues të UP-së, është pjesë e kulturës që shoqëron udhëheqjen time, prandaj instalimi i vlerave dhe parimeve të përgjithshme në UP, krahas përmbushjes së dhjetë objektivave të parashikuara në këtë program, konsiston në përmbushjen e misionit dhe vizionit për mandatin dyvjeçar.

Besoj se ky është programi më i mirë që mund të ofrojë një kandidat për rektor dhe me përmbushjen e objektivave të përcaktuara, garantoj se UP-ja do të ngritet në konturet e një institucioni të besueshëm, me vlerë të shtuar dhe i respektuar në rajon dhe më gjerë.